



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
FAKULTETI I EKONOMISË
NJËSIA PËR SIGURIMIN E BRENDSHËM TË CILËSISË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM
FAKULTETI I EKONOMISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË

NJËSIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË

Dr. Aida Mosko

Kryetare

Doc. Dr. Marinela Teneqexhi

Anëtar

Dr. Denada Olli

Anëtar

Silvia Goçi (Student)

Anëtar

VITI AKADEMIK 2021-2022

PARATHËNIE PËR PROCESIN E VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

PARIMET E PUNËS SË NJSBC

- Vlerësimi i Cilësisë duhet të karakterizohet nga profesionalizmi, vërtetësia, objektiviteti, paanshmëria, transparenca e plotë dhe përfshirja e të gjithë aktorëve në të gjitha fazat e vlerësimit.
- Zhvillimi i Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë (SBSC) në Njësitë e IAL realizojnë vlerësimin e brendshëm me synimin që të krijohet një pamje e qartë dhe transparente e njësisë nën vlerësim, për të ndërtuar politika zhvillimi në përputhje me misionin e saj dhe të shërbejë si bazë për procesin e mëtejshëm të akreditimit të IAL-së dhe të programeve të studimit.
- Të bëjë publik informacionin me qëllim që të gjithë partnerët dhe publiku i gjerë (studentët, prindërit, stafet akademike dhe ndihmëse, partnerët e tjerë socialë, ekonomikë e politikë) të informohen për gjendjen e njësisë, programeve, kurrikulave, shërbimeve, etj.
- Të shërbejë për kultivimin e Kulturës së Cilësisë në IAL si pjesë e brendshme dhe e qëndrueshme.
- Vlerësimi të bëhet i mbështetur në dokumente, procedura, anketime, takime me palët e interesuara etj.

PJESA PËRSHKRIMORE DHE ELEMENTËT SHPJEGUES

Universiteti “Fan S. Noli” Korçë në gjithë veprimtarinë e tij ka për mision kryesor të krijojë, të zhvillojë, të përcjellë dhe të mbrojë dijet me anë të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor,

- të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit, duke kontribuar në rritjen e standardeve të demokracisë në vend;
- të kontribuojë në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor në nivel kombëtar dhe rajonal;
- të mbështesë prioritetet strategjike dhe interesat e zhvillimit të vendit; të integrojë mësimdhënien me kërkimin shkencor , si dhe të nxisë bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e arsimit të lartë.

Nëpërmjet këtij raporti NJSBC do të evidentojë përmbushjen e standardeve të cilësisë për të gjitha fushat e veprimtarisë së UNIKO. Informacioni dhe të dhënat që do të nxirren nëpërmjet këtij raporti do të shërbejnë si indikatorë për përmirësimin e veprimtarisë së njësisë kryesore dhe atyre bazë në UNIKO, si dhe do të vendosen në dispozicion të proceseve të vlerësimit të jashtëm institucional ose të programeve të studimit.

HYRJE

Ky raport prezanton rezultatet e procesit të vlerësimit të brendshëm të cilësisë së programeve profesionale, referuar Nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikime, programeve të ciklit të parë të studimit “Bachelor” dhe programeve të ciklit të dytë “Master” në Fakultetin e Ekonomisë, Universiteti “Fan S. Noli” në Korçë, kryer nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm.

Qëllimi i këtij procesi është që të sigurojë një vlerësim korrekt, të bazuar në tregues realë dhe të matshëm të nivelit të arritjes së standardeve dhe garantimit të cilësisë së programit të studimit të përfshirë në vlerësim, të përgatisë një raport i cili do të shërbejë si bazë për grupin e vlerësimit të jashtëm, gjatë procesit të akreditimit.

Për të përmbushur me sukses këtë qëllim, NJSBC është bërë pjesë e trajnimeve paraprake të organizuara nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pranë Universitetit, mbi bazën e përvojës së vlerësimeve të mëparshme, duke hartuar edhe një plan pune, duke ndarë detyrat dhe duke udhëzuar NJSBC për përmbushjen e detyrave.

Për hartimin e këtij raporti, NJSBC ka mbajtur parasysh raportin e viteve të kaluara, si dhe raportin e GVJ që është realizuar në kuadër të akreditimit institucional.

Gjithashtu u shfrytëzuan të gjitha materialet, të dhënat e Fakultetit, vlerësimet e kryera nga studentët për procesin mësimor, për stafin akademik, për infrastrukturën. Dokumentacioni bazë, mbi të cilin u mbështet procesi i Vlerësimit të Brendshëm në Fakultetin e Ekonomisë

- Ligj nr. 80/2015, për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë
- Standardet shtetërore të cilësisë për vlerësimin dhe akreditimin e programeve të studimeve
- Raporti i Vlerësimit Institucional i Universitetit "Fan S. Noli" Korçë Prill 2017
- Analiza e punës mësimore–shkencore 2018-2019 për Fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë
- Udhëzimet e MASR-së
- Dokumente të veprimtarisë institucionale të Universitetit “Fan S. Noli”, më konkretisht:
 - Statuti i UK-së,
 - Rregullore e UK-së,
 - Rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë
 - Rregulloret e Programeve të studimit
 - Rregullore e transferimeve - Rregullore PITAGORA
 - Planet mësimore - Formularët e ngarkesës vjetore të stafit

Burimet e të dhënave:

- Sekretaria mësimore e Fakulteti të Ekonomisë
- Zyra e Statistikës
- Dega e Financës
- Website i Universitetit “Fan.S.Noli”, Korçë.

SKEDA INFORMATIVE

Fakulteti	Fakulteti i Ekonomisë	
Adresa:	Shëtitorja “Rilindasit” Korçë	
E-mail	rektorati@yahoo.com	
Liçensuar	VKM, nr. 5, dt. 7 janar 1992	
Statusi aktual ligjor	I akredituar	
Përfaqësuesi zyrtar	Prof.as.dr.Ledina Alolli Tel.++ 355 82242201	Dekan
	e-mail: lalolli@unkorce.edu.al	
Struktura akademike	Departamenti Financë-Kontabilitet	
	Departamenti i Menaxhimit	
	Departamenti Marketing-Turizëm	
Oferta Akademike:	Cikli i Parë i Studimeve (Bachelor) (Niveli 6 KSHK)	
	Cikli i Dytë i Studimeve (Master i Shkencave, Master Profesional) (Niveli 7 KSHK)	

Aktualisht, fakulteti i Ekonomisë operon mbi bazën e programeve të reja mësimore, në përputhje me programet e shkollave perëndimore, bazuar në deklaratën e Bolonjës dhe të përshtatura ndaj kushteve aktuale të vendit tonë.

Stafi i fakultetit punon për të përmirësuar vazhdimisht raportet dhe standartet që kërkon kjo deklaratë. Krahas angazhimit për një mësimdhënie cilësore, personeli i fakultetit është i angazhuar në një punë studimore-shkencore e botuese, në funksion të procesit mësimor, duke dhënë njëkohësisht kontribut profesional në fushat e financë- kontabilitetit, menaxhimit, marketingut dhe turizmit.

Mbi bazën e eksperiencës së fituar janë hartuar programet mësimore për të gjitha nivelet në përputhje me kërkesat që shtrohen për përgatitjen e specialistëve, sipas kërkesave të tregut.

Gjithashtu Fakulteti i Ekonomisë jep kontributin e tij shkencor e profesional në fusha e sektorë të ndryshëm të ekonomisë e biznesit në rajon dhe më gjerë.

Një kontribut i vlerësuar është në fushën e kërkimeve shkencore në formën e artikujve, monografive, referimeve në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, etj.

Të gjitha përditësimet e programeve të studimit në Fakultetin e Ekonomisë, marrin parasysh përvojën më të mirë në nivel kombëtar, si dhe tendencat e zhvillimeve më të fundit europiane.

Objektivat e vendosura për vitin 2019-2020:

- a.** Rritja e nivelit të mësimdhënies dhe e të nxënit.
- b.** Përmirësimi i vazhdueshëm i kurrikulave me literaturë bashkëkohore.
- c.** Kualifikimi i pedagogëve përmes formave të ndryshme të kualifikimit (si individuale ashtu edhe ato të organizuara apo të mbështetura nga Fakulteti).
- d.** Pjesëmarrja në projekte duke synuar rritjen e cilësisë së punës në Fakultet.
- e.** Rritja e bashkëpunimit me Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Tiranës si dhe me Fakultete të tjera ekonomike brenda dhe jashtë vendit.
- f.** Këto janë objektivat e përgjithshme, por Departamentet në varësi të prioriteteve kanë vendosur edhe objektiva të veçanta, realizimi i të cilave është pasqyruar në raportet e secilit Departament.

OBJEKTIVAT DHE REZULTATET E NJSBC

Raporti i vlerësimit të brendshëm të Fakultetit të Ekonomisë përfshin programet e nivelit të parë, bachelor dhe të dytë master profesional dhe master shkencor. Ky raport u përgatit nga grupi i vlerësimit të brendshëm dhe do të shërbejë si një bazë e mirë për procesin e akreditimit të programeve të vecanta të studimit. Vlerësimi i programeve të studimit u realizua duke u bazuar në standartet. Duhet të theksojmë se, studimet sipas kritereve të Kartës së Bolonjës në Fakultetin e Ekonomisë filluan në vitin akademik 2005-2006. Paraprakisht u krijua një grup pune për ristrukturimin e planeve dhe programeve mësimore, në bashkëpunim edhe me Fakultetin e Ekonomisë të universitetit të Tiranës. Në Qershor 2006 filloi dhe procesi i vetvlerësimit të Fakultetit të Ekonomisë në bazë të udhëzimeve të Agjencisë Kombëtare të Akreditimit. Pasi u realizua vlerësimi i brendshëm i cilësisë nëpërmjet hartimit të raportit të vetvlerësimit u realizua edhe vlerësimi i jashtëm i Fakultetit të Ekonomisë, i cili u pasqyrua në Raportin e Vlerësimit të Jashtëm.

Grupi i punës i ngritur për vlerësimin e brendshëm të cilësisë në Fakultetin e Ekonomisë përbëhet nga pedagogët: Dr. Aida Mosko, Doc. Dr. Marinela Teneqexhi, Dr. Denada Olli dhe ka një eksperiencë disa vjecare. Ai ka qënë pjesë e trajnimeve të organizuara nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pranë Universitetit. Për të realizuar këtë raport GVB hartoi kalendarin e aktiviteteve për të siguruar të dhënat dhe informacionin e nevojshëm. Gjatë punës grupi i vetvlerësimit ka pasur kontakte të vazhdueshme me: anëtarët e tjerë të grupeve të vlerësimit të brendshëm në fakultetet e tjera; Rektoratin e Universitetit, Dekanin e Fakultetit të Ekonomisë, përgjegjësat e departamenteve, stafin e pedagogeve si dhe stafin ndihmës-mësimor.

Qëllimi i këtij raporti është që të sigurojë një vlerësim të programeve të studimit bazuar në tregues realë dhe të matshëm.

I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT

Standardi I.1

Njësia e institucionit të arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.

Modeli i zhvillimit ekonomik të vendit kërkon që specialistët të kenë një qasje inovative, punë krijuese, shkencore, të bazuar në njohuri dhe vendimmarrje të përgjegjshme.

Programi i studimit të këtij Fakulteti ofrohet në përputhje me misionin dhe vizionin e Universitetit "Fan S. Noli" (referuar në vijim si UK) dhe të Fakultetit të Ekonomisë (referuar në vijim si FE)

Universiteti "Fan S. Noli" ka për mision "*.... të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit.... të kontribuojë në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor në nivel kombëtar dhe rajonal....*" Po në të njëjtën linjë misioni i Fakultetit të Ekonomisë thekson "*.... për të formuar dhe përgatitur specialistët e ardhshëm që t'i përshtaten situatave konkurruese të tregut në zgjidhjen e problemeve ekonomike nëpërmjet zhvillimit dhe transmetimit të dijeve me anën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.*"

Programet e studimit përmbajnë objektiva të qarta të cilat janë vendosur mbështetur në përputhje me perspektivat e zhvillimit ekonomik të vendit, kërkesave të tregut të punës dhe interesave të punëdhënësve. Nëpërmjet një kurrikule në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit, studentët fitojnë kompetenca profesionale për të marrë vendime dhe veprime në përshtatje me situatat reale konkurruese të tregut.

Standardi I.2

Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të njësive të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.

Në përputhje me fushat strategjike të Planit Strategjik të Zhvillimit të UNIKO¹ dhe në zbatim të tij, programet e studimit të FE ofrojnë *arsimim cilësor* në funksion të përmbushjes të pritshmërive të studentëve, për njohuri bashkëkohore dhe praktike, në funksion të karrierës profesionale (objektivat strategjike A1-A3-A4) dhe që reflektojnë *rezultatet e vazhdimësisë të kërkimit shkencor* dhe përpjekjeve për të aplikuar praktikat më të mira në këtë fushë (objektivat strategjike B1-B2-B3).

Programet e studimit hartohen nga njësi bazë dhe miratohen nga Senati Akademik i UNIKO² dhe Rregullore e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore Shkencore e

¹ Plani Strategjik i Zhvillimit të Universitetit "Fan S. Noli" 2022-2027

² Statuti i Universitetit "Fan S. Noli", Kreu VI, Neni 47, Pika (3)

Universitetit "Fan S. Noli"³, në përputhje me drejtimet e synuara nga UNIKO " - të përgatisë profesionalisht specialistë të lartë në fushat që mbulon në të gjithaprogramet e studimit, nëpërmjet mësimdhënies dhe praktikave profesionale" në përmbushje të misionit të tij⁴.

Programet e studimit që ofrohen në FE kontribuojnë në përmbushjen e vizionit të FE për të qenë ".....zgjedhja e studentëve të Rajonit Juglindor dhe më gjerë duke garantuar një mjedis atraktiv në të cilin çdo student mund të jetë i suksesshëm".⁵

II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT

Standardi II.1

Standardi II.1 - Programet e studimit synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës

Fakulteti i Ekonomisë iu ofron studentëve kushte për edukimin e tyre në përputhje me sfidat e Integritimit Europian për të formuar dhe përgatitur specialistët e ardhshëm që t'i përshtaten situatave konkurruese të tregut në zgjidhjen e problemeve ekonomike nëpërmjet zhvillimit dhe transmetimit të dijeve me anën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor . Përmbushja e këtij misioni realizohet përmes katër objektivave:

- Të ofrojë njohuri bazë shkencore-teorike, bashkëkohore në fushën e ekonomisë
- Të ofrojë njohuri praktike për t'iu përshtatur sa më mirë dhe sa më shpejt detyrave konkrete në vendet e punës.
- Të rritë aftësitë teorike dhe praktike duke bërë profilizimin profesional
- Të krijojë mundësi për kualifikimin e vazhdueshëm të specialistëve të rinj në fushën e ekonomisë
- Të forcojë lidhjet dhe shkëmbimet me fakultetet e tjera homologe brenda dhe jashtë vendit.
- Të luajë një rol aktiv si pjesëmarrës në projekte kërkim-zhvillimi duke ju përgjigjur perspektivës së zhvillimit të Rajonit

Programet e studimit që ofron FE-sw kanë të gjitha objektiva të qarta të orientuara tek

- pajisa e studentëve me njohuri më të thelluara teorike dhe praktike si dhe me trajnim të mirëfilltë profesional në fushën ku ata studiojnë dhe në fusha të tjera të lidhura me të
- të pajisë studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale
- të përgatisë specialistë të aftë me njohuri të nevojshme në fushën e shërbimeve financiare, të kontabilitetit, marketingut, turizmit dhe menaxhimit të biznesit për të punuar dhe për të kontribuar në zhvillimin e vendit
- të përgatisë specialistë të motivuar për të punuar si në sektorin privat ashtu edhe në

³ Rregullore e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore Shkencore e Universitetit "Fan S. Noli", Kreu VI, Neni 56, Pika (3)

⁴ Statuti i Universitetit "Fan S. Noli", Kreu I, Neni 2, Pika (1)

⁵ Vizioni i FE paraqitet tek Plani i Zhvillimit i FE

institucione publike dhe strategjike të vendit

Standardi II.2

Standardi II.2 - Programet e studimit synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare

Programet e studimit qv ofrohen nga FE janw në përputhje me misionin dhe vizionin e UK, të FE, në përputhje me strategjinë për zhvillimin e FE.

Programet janw hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe me zhvillimin ekonomik të vendit dhe nuk bien ndesh me interesat dhe programet e ofruara nga institucione të tjera të arsimit të lartë.

Ky program studimi ka në fokus transmetimin e njohurive teorike dhe praktike tek studentët që të përballojnë çdo sfidë në tregun aktual të punës. Kurrikula e programit “Financë-Kontabilitet”⁵ është e pasur me module nga autorë shqiptarë dhe të huaj të cilët janë ekspertë të ekonomisë dhe tregjeve financiare.

*“UK-ja në gjithë veprimtarinë e tij ka për mision kryesor të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë dhe të mbrojë dijet me anë të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve”*⁶ Siç shihet, programi i studimit Bachelor në Financë - Kontabilitet është i shprehur në mënyrë të qartë në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë e shprehur në Planin Strategjik 2021–2026 të FE.⁷

Fakulteti i Ekonomisë iu ofron studentëve kushte për edukimin e tyre në përputhje me sfidat e Integritit European për të formuar dhe përgatitur specialistët e ardhshëm që t’i përshtaten situatave konkurruese të tregut në zgjidhjen e problemeve ekonomike nëpërmjet zhvillimit dhe transmetimit të dijeve me anën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencors. Përmbushja e këtij misioni realizohet përmes këtyre objektivave:

- Të ofrojë njohuri bazë shkencore-teorike, bashkëkohore në fushën e ekonomisë.
- Të ofrojë njohuri praktike për t’iu përshtatur sa më mirë dhe sa më shpejt detyrave konkrete në vendet e punës.
- Të rritë aftësitë teorike dhe praktike duke bërë profilizimin profesional.
- Të krijojë mundësi për kualifikimin e vazhdueshëm të specialistëve të rinj në fushën e ekonomisë.
- Të forcojë lidhjet dhe shkëmbimet me fakultetet e tjera homologe brenda dhe jashtë vendit.
- Të luajë një rol aktiv si pjesëmarrës në projekte kërkim-zhvillimi duke ju përgjigjur perspektivës së zhvillimit të Rajonit.

Standardi II.3 - Njësia, për akreditimin e programeve të studimeve, përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e tyre

Elementë referues të raportit

Sektori i Kurrikulës Vlerësimit Institucional dhe Alumni është i përfshirë drejtpërdrejt në matjen e treguesve kyç të performancës së programeve të studimit dhe në hartimin e një plani pune për përmirësimet e mundshme. Veprimtaria e tij përshkruhet edhe në Manualin e Sigurimit të Cilësisë të UNIKO dhe detajohet në planin kalendarik të veprimtarisë së këtij sektori. Ai koordinon punën e Njësive të SBC në fakultete dhe i raporton drejtpërdrejt autoriteteve të universitetit për masat që duhet të ndërmerren. Kjo njësi bën vlerësimin periodik të efikasitetit të veprimtarive mësimore dhe shkencore dhe ka pavarësi veprimi dhe akses në të dhënat e universitetit.

Stafi akademik është i përfshirë në çështje që kanë të bëjnë me sigurimin e cilësisë së programeve të studimit. Orët e hapura të mësimit kanë shërbyer si mjet për shkëmbimin e përvojave mes stafit akademik më me përvojë dhe stafit më të ri në profesion. Anëtarët e grupeve që kanë marrë pjesë në projekte janë përfshirë në organizimin e trajnimeve me stafin akademik në drejtim të përmirësimit të metodologjisë dhe infrastrukturës së mësimdhënies.

Sistemi i sigurimit të cilësisë përfshin një sërë mekanizmash dhe mjetesh të cilat në mënyrë periodike (të përvitshëm) përdoren nga njësitë e UNIKO në përmbushjen e standardeve të cilësisë.

Mekanizmat dhe mjetet për sigurimin e cilësisë përfshijnë elementë të planifikimit, kontrollit, vlerësimit dhe strategjitë e përmirësimit të çështjeve të veçanta të fushave të standardeve të cilësisë.

Në nivel fakulteti ka pasur vetëvlerësim po nuk ka pasur vlerësime të jashtme dhe auditime. Njësia bazë në mënyrë të përvitshme harton raportet e veprimtarisë institucionale të cilat përfshijnë analizën e procesit mësimor dhe atë të kërkimit shkencor me të gjithë komponentët e vlerësimit të tyre²²⁹. Informacioni i këtyre raporteve është pjesë e raporteve të vlerësimit në nivel fakulteti.

Ky vetëvlerësim programor është i pari dhe do të pasohet nga vlerësimi i jashtëm i kryer nga ASCAL.

Drejtoria e Kurrikulave, Sigurimit të Cilësisë dhe Kërkimit Shkencor, në bazë të rregullores²³⁰, monitoron analizat dhe vlerësimin e proceseve akademike që kontrollohen gjatë vitit dhe rezultatet e tyre i raporton pranë rektoratit dhe dekanateve të fakulteteve. Gjithashtu zyra përgatit në mënyrë të përvitshme analizën e veprimtarisë mësimore të Universitetit dhe ja referon atë Senatit.

Nga analiza e vlerësimeve janë nxjerrë rekomandime dhe janë lënë detyra në lidhje me rregullsinë e procesit mësimor dhe cilësinë e mësimdhënies.

Në lidhje me marrjen dhe përgatitjen e informacionit për probleme të mësimit dhe vlerësimit institucional, Drejtoria e Kurrikulave mban lidhje me MASR nëpërmjet zëvendës-rektorit për mësim.

Njësia kryesore përgjegjëse për programin “Financë-Kontabilitet” mbështetur në rregulloren e saj organizon në fund të çdo viti akademik rishikimin periodik të programit të studimit dhe rregullores mësimore të tij. Në fokus të këtij rishikimi janë modulet, kreditet, baza e nevojshme didaktike për realizimin e programit të studimit, literatura e përdorur, procedura e kontrollit të dijeve/provimeve dhe analiza e rezultateve të kontrollit.

Në rishikimin e programit merren parasysh problematikat e ngritura nga pedagogët, si edhe çështjet e evidentuara nga anketimi periodik i studentëve. Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies kryhet si nëpërmjet analizave periodike ashtu edhe nëpërmjet anketimit të studentëve.

Standardi II.4 - Programet e studimit janë të detajuara dhe informuese

Elementë referues të raportit

Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve dhe njohurive në programet e studimit të FE janë të shumëllojshme, gjë e cila reflektohet dhe në syllabuset përkatëse të moduleve të këtij programi studimi⁷¹. Disa nga format e ndryshme të mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve janë leksionet, seminarët, detyrat e kursit, praktikat profesionale etj. Krahas tyre ngelet e hapur mundësia që të përdoren dhe forma të tjera të reja të vlerësimit, të cilat mund të jenë të dobishme për përmirësimin e procesit të mësimdhënies apo mësimnxënies.

Personeli akademik njih dhe pranon diversitetin dhe nevojat e studentëve, dhe e reflekton këtë në përdorimin e metodave të ndryshme të mësimdhënies dhe mësimnxënies duke marrë në konsideratë këto diferenca. Pjesa kryesore e moduleve të programit të studimit

përbëhen nga module që lidhen me fushën e studimit. Format e mësimdhënies të përdorura gjatë vitit të parë dhe të dytë të studimeve janë leksionet dhe seminarët, ndërsa në vitin e tretë krahas tyre shtohet dhe praktika profesionale, e cila synon njohjen e studentëve me çështje praktike të profesionit të tyre të ardhshëm. Kjo mundëson që ata të familjarizohen me çështje të ndryshme praktike të punës së tyre.

Pjesa më e madhe e moduleve përfshijnë seminare dhe një pjesë e tyre kanë të planifikuara detyra ose projekte kursi. Format e përdorura të mësimdhënies dhe numri i orëve dokumentohet në syllabusin përkatës të secilit modul.

Angazhimi i stafit akademik dhe në programet e shkëmbimeve Erasmus + ka bërë të mundur që stafi akademik të përfitojë nga këto eksperiencë dhe metoda të reja të mesimdhënies, duke mundësuar kështu përshtatjen e metodave të mësimdhënies sipas nevojave të studentëve.

Pavarësisht nivelit të kualifikimit universiteti mbështet kualifikimin e vazhdueshëm të stafit akademik, me qëllim që të sjellin metoda të reja të mësimdhënies, apo të bëjnë pjesë të moduleve të tyre dhe çështje specifike që mund të jenë me interesa dhe nga ana praktike, duke ju referuar dhe duke marrë në konsideratë dhe nevojat apo kërkesat e punëdhënësve. Metodatat e ndryshme të kualifikimit përfshijnë trajnime, leksione të hapura, etj.

Stafi akademik përdor metoda të shumëllojshme dhe interaktive për të stimuluar punën dhe pjesëmarrjen e studentëve në mësim. Për të realizuar këtë një pjesë e rëndësishme e punës janë dhe detyrat apo projektet e kursit të cilat synojnë të nxitin studentët të jenë sa më aktivë gjatë mësimit. Duke qënë se një pjesë e mirë e detyrave zgjasin për një periudhë kohe, synojnë ti mbajnë studentët të angazhuar në mënyrë të vazhdueshme edhe jashtë orëve mësimore. Shpesh përdoret dhe puna në grup gjatë projekteve me qëllim që të nxitet bashkëpunimi midis studentëve. Pavarësisht se një pjesë e detyrave përfshijnë në një pjesë të mirë punën e studentëve jashtë orëve mësimore,

stafi akademik ofron mbështetje në çdo hap për studentët, duke ndihmuar si në realizimin e një pune të mirë për studentët, por në të njëjtën kohë shërben dhe si një mjet i dobishëm për krijimin e marrëdhënieve të ndërsjellta të respektit pegagog-student.

III - PERSONELI I NJËSISË SË INSTITUCIONIT

Standardi III.1 - Njësia e institucionit ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit

Elementë referues të raportit

Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Komunikimit dhe Promocionit administron bazën e të dhënave mbi personelin akademik, ndihmës mësimit shkencor dhe administrativ, bazuar në nenin 4, pika c dhe neni 5, pika 3 e rregullores së kësaj drejtorie.⁹³

Midis të tjerash kjo bazë të dhënash përfshin dhe dokumentacion mbi organikën si dhe jetëshkrimet e stafit akademik që mbulon programin e studimit⁹⁵ dhe atij ndihmësmësimit dhe administrativ⁹⁶ si dhe listën e personelit të punësuar pranë UNIKO⁹⁷.

Mbështetur në standartet e cilësisë, çdo vit departamenti Financë- Kontabilitet realizon vlerësimin e performancës në mësimdhënie mbështetur tek anketimi i studentëve⁹⁸. Departamenti realizon periodikisht analizën mësimore dhe kërkimore pjesë e së cilës është dhe vlerësimi i personelit. Gjithashtu Sektori i Kurrikulës Vlerësimi Institucional dhe Alumni në bashkëpunim me Njësitë e Sigurimit të Brendëshëm të Cilësisë bazuar në Nenin 103, pika 3 të ligjit nr.80/2015 për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL, organizon pyetësorin studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e programit të studimit.⁹⁹

UNIKO ndjek një politikë të hapur të punësimit dhe të rekrutimit të burimeve njerëzore. Procedurat e përzgjedhjes janë të hapura, me konkurs dhe me objektiv përzgjedhjen e personave të kualifikuar që zotërojnë grada e tituj shkencorë. Institucioni ka një Udhëzim të posaçëm rekrutimi. Kjo procedurë administrohet nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Komunikimit dhe Promocionit. Për rekrutimin e personelit është ndjekur procedura e shpalljes publike të pozicionit të punës, dhe të kritereve në Buletinin e Njoftimeve Publike si dhe në website e Universitetit. Në njoftim institucioni shpall ofertën e punës me kërkesat

specifike që ka propozuar njësia bazë dhe dekanati, të miratuara nga titullari i insitucionit. Me publikimin e shpalljes së vendit vakant në Buletinin e Njoftimeve Publike (VKM nr.176 dt.29.03.2006 “Për botimin e Buletinit të Njoftimeve Publike”) dhe në faqen zyrtare të UNIKO, kandidatëve potencialë ju jepet mundësia të depozitojnë dokumentacionin përkatës brenda afatit të përcaktuar në njoftim.

Krieret e punësimit sanksionojnë zhvillimin e një konkursi publik, të hapur dhe të paanshëm. Në nenin 40 të Statutit të UNIKO,¹⁰⁰ përcaktohet procedura e rekrutimit, e zhvillimit të konkursit si dhe e ngritjes së Komisionit Ad Hoc. Kompetenca themelore e këtij komisioni të posacëm është shqyrtimi i pajtueshmërisë së dokumentacionit të depozituar nga ana e kandidatëve, me kriteret e përgjithshme të përcaktuara në ligj dhe rregullore dhe kriteret specifike të përcaktuara nga njësia bazë.

Për të diferencuar cilësinë e personelit, epërsi i jepet kriterit të specialitetit të diplomës universitare dhe notës mesatare, i cili është edhe kriter skualifikues.

Në pikën 5 të këtij udhëzimi, parashikohet se në rast se, në fund të procesit të vlerësimit do të rezultojnë kandidatë me pikë të barabarta, atëherë përparësi do t'i jepet kandidatit që zotëron diploma të fituara në universitete të njohura të vendeve të njohura të OECD.

Pas përzgjedhjes së kandidatit fitues, nënshkruhet Kontrata individuale e punës ndërmjet tij dhe Rektorit si autoriteti përfaqësues i UNIKO. Pas nxjerrjes së urdhërit të emërimit prej Rektorit, kandidati fitues ushtron të kompetencat e marra përsipër në kontratën individuale të punës.

Departamenti i Burimeve Njerëzore, Komunikimit dhe Promocionit arkivon një bazë të plotë të dhënash të procedurave të punësimit, të kuadrit ligjor, të dokumentacionit përkatës dhe të marrëveshjeve të nënshkruara në përfundim të gjithë procesit.

Institucioni ka zbatuar ligjin 80/2015 në rekrutimin e punonjësve akademikë. Kriteret specifike të rekrutimit propozohen nga Departamenti dhe miratohen nga Rektorati. Senati Akademik i UNIKO ka vendosur kriteret bazë për rekrutimin e personelit, të cilat janë bërë publike në çdo konkurs. Në kriteret e vendosura për rekrutim personeli, përparësi kanë ata që janë kualifikuar jashtë vendit. Në përzgjedhjen e personelit, institucioni i ka dhënë përparësi personave, të cilët janë kualifikuar në universitetet perëndimore. Gjithashtu sëbashku me kriteret, është pasqyruar edhe mënyra e vlerësimit të tyre, e cila bëhet publike në çdo konkurs¹⁰².

Veprimtaria rekrutuese e UNIKO karakterizohet nga transparenca ndaj publikut, paanshmëria, shanse të barabarta të konkurimit dhe zbatim rigoroz i kriterëve ligjore të parashikuara në nenin 64, pika 1 të Ligjit nr. 80/2015 dhe Kodit të Punës. Nenit 32 i Rregullores të Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore e Shkencore të UNIKO¹⁰³, në zbatim të këtij ligji, parashikon kriteret e përgjithshme. Kriteret specifike propozohen nga njësia bazë dhe miratohen nga Rektori i UNIKO .

Përsa i përket rekrutimit të pedagogëve të jashtëm, procedura paraprihet nga një mbledhje e zhvilluar në nivel departamenti. Në këtë mbledhje diskutohet në lidhje me parashikimin e ngarkesës mësimore si dhe propozohen kriteret specifike në bazë të disiplinës që do të mbulohet. Gjithashtu kjo disiplinë duhet t'i përshtatet specialitetit përkatës.

Standardi III.2 - Njësia e institucionit disponon një bazë të dhënash për personelin e tij

Elementë referues të raportit

Fakulteti i Ekonomisë ka një staf kompetent dhe të plotë që i përkasin brezave të ndryshëm dhe si i tillë është një mjedis stimulues për shkëmbimin e përvojës në mësimdhënie.

UNIKO është angazhuar në politikat integruese të personelit të vet, duke i dhënë mundësi për trajnime dhe kualifikime të ndryshme në përputhje me fushat e studimit. Gjithashtu Universiteti ka ndjekur politikat për të integruar personelin duke e përfshirë atë nëpër projekte dhe veprimtari të ndryshme shkencore. Mobiliteti i stafit akademik për qëllime specializimi, në kuadër të marrëveshjeve me institucione arsimore apo qendra kërkimi jashtë vendit dhe riintegrimi i tyre në rradhët e personelit akademik ka qenë dhe mbetet

një faktor i rëndësishëm për rritjen e kapaciteteve akademike. Personeli akademik nxitet vazhdimisht për të realizuar kualifikime apo specializime, si pjesë e përparimit akademik ose në funksion të mësimdhënies.

UNIKO përkrah stafin akademik duke mbështetur nismat e tij për kualifikime, duke nxitur botimin e punës kërkimore në "Buletinin Shkencor" të universitetit, duke organizuar aktivitete shkencore brenda universitetit me pjesëmarrjen e personelit të tij akademik, duke organizuar takime vlerësuese për stafin e ri të kualifikuar, duke vlerësuar kontributin e stafit me përvojë përmes certifikatave dhe shpërblimeve, duke angazhuar disa prej tyre në veprimtaritë jashtëkurrikulare në mbështetje të institucionit, duke rritur numrin e pjesëmarrësve në projektet e mobilitetit të stafit dhe duke mbuluar koston financiare të botimeve akademike të stafit.

Gama e mjeteve promovuese të sipërpërmendura duhet të zgjerohet edhe më shumë, fakulteti duhet të gjejë mënyra më specifike për promovimin e përvojave të suksesshme të stafit, në mënyrë që prezantimi i arritjeve të tyre akademike të kthehet në një qasje të natyrshme të performancës së njësisë.

Standardi III.3 - Njësia e institucionit angazhon personel ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij

UNIKO disponon sisteme të integruara informacioni si bashkëpunues në projektin e RASH. Ky projekt garanton sisteme të menaxhimit gjithpërfshirës të informacionit duke mundësuar sigurimin e informacionit strategjik, duke kombinuar aplikacionet kryesore administrative si: të mësuarit dhe studenti, kërkimi, burimet njerëzore, kontabiliteti etj (PITAGORA, UGOV dhe IRIS). I gjithë informacioni për studentët dhe aktivitetin e tyre administrohet nëpërmjet sistemit PITAGORA që përfshin një sekretari elektronike të plotë¹¹⁰.

Gjithashtu UNIKO ka marrëveshje me RASH me anë të së cilës realizon menaxhimin e karrierës së studentëve si: hyrjen (regjistrimin e tyre në programe studimi) dhe lëvizjet (transferimet e tyre), faturimet, pagesat, menaxhimin e mësimdhënies, klasat, transkriptet e notave.

Sistemi PITAGORA i referuar më lart, administron gjithashtu dokumentacionin e hartuar nga pedagogu në lidhje me vlerësimin e studentëve, çka përbën informacionin më të rëndësishëm. Pjesa tjetër e dokumentacionit janë dhe regjistrat e pedagogut që kontrollohen nga përgjegjësi i departamentit dhe nga grupi i punës i ngritur nga Rektorati çdo vit akademik.

Sistemi përdoret njëherazi nga studentët, pedagogët dhe sekretaret dhe ka të integruar edhe sistemin e pagesave me bankë të tarifave dhe pagesave për shërbime. Për çdonjërin nga këta përdorues ka një udhëzues për përdorimin e modulit përkatës. Sistemi PITAGORA siguron akses të dedikuar por njëkohësisht është i mbrojtur nga ndërhyrjet.

Në dispozicion të stafit akademik dhe studentëve të UNIKO është një librari digjitale (U-Library) që mundëson aksesimin on line të revistave shkencore. Libraria është e aksesueshme nga të gjithë studentët dhe pedagogët nëpërmjet laptopëve, tabletave, apo telefonave smart, kompiuterave.

Në hollin e godinës të fakultetit janë instaluar monitorë dhe stenda, në të cilët paraqiten në mënyrë të vazhduar njoftime dhe materiale që orientojnë, ndihmojnë dhe informojnë studentët.

Informacioni për programet është i publikuar në faqen e internetit të UNIKO www.uniko.edu.al, Informacioni është në gjuhën shqipe dhe atë angleze, ai përditësohet vazhdimisht.

Sistemet e informacionit të lartpërmendura respektojnë dispozitat e ligjit 9887 për mbrojtjen e të dhënave personale

Standardi III.4 - Njësia e institucionit angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij

Universiteti “Fan S. Noli” ka një staf akademik dhe kërkimor me kohë të plotë shumë të madh dhe të kualifikuar⁶². Personeli i Fakultetit të Ekonomisë ka një shkallë të lartë kualifikimi. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien e këtij programi ka kompetencë dhe përvojë të gjatë mësimdhënie⁶⁴. Informacioni i plotë për punonjësit akademik gjendet në dosjen e plotë pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Pagave.

Kualifikimet dhe përvoja didaktike e çdonjërit nga lektorët është në përputhje të plotë me modulën që mbulon në këtë program studimor, duke respektuar bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të tij. Në mënyrë të veçantë, stafi i departamentit i angazhuar në programin “Financë-Kontabilitet” i përket kategorisë profesor dhe lektor dhe ka një përvojë pedagogjike të gjatë.

Edhe personeli ndihmës akademik i angazhuar është gjithashtu me përvojë të gjatë pune⁶⁵. Në rastin e mbikqyrjes gjatë praktikave profesionale, rekomandohen ato subjekteve, publike dhe private, me të cilat UNIKO, Fakulteti i Ekonomisë apo Departamentet kanë marrëveshje dhe që garantojnë cilësinë e zhvillimit të praktikës.

Prej disa vitesh universiteti ka në përdorim një infrastrukturë të konsoliduar IT, e cila u vjen në ndihmë si pedagogëve dhe studentëve. Kjo infrastrukturë mundëson informimin online të studentëve në lidhje me vlerësimin e vazhduar dhe atë përfundimtar, pra komunikimin elektronik pedagog-student. Një pjesë e rëndësishme e infrastrukturës së IT-së, që vjen në ndihmë të stafit akademik dhe të studentëve është dhe sistemi elektronik i vlerësimit të studentëve (<https://unk.pitagora.rash.al>). Ky sistem mundëson informimin e studentëve në kohë reale në lidhje me rezultatet e provimeve si dhe rrit përgjegjshmërinë e pedagogëve në vlerësimin e studentëve si dhe transparencën e gjithë procesit.

Për gjithë modulet e programeve ekziston literatura bazë në gjuhën shqipe. Cilësia e literaturës bazë si dhe përputhshmëria e përmbajtjes së tyre me atë të programit të studimit garantohej përmes diskutimit dhe miratimit në departament të teksteve mësimore. Tekset mësimore bazë janë të disponueshme në librarinë pranë UK, si dhe një pjesë e teksteve mësimore sigurohen nga autorë të fushës jashtë UK. Pjesa më e madhe e teksteve janë unike dhe me referencë në nivel kombëtar duke i shërbyer krahas studentëve dhe specialistëve të fushës. Tekstet kanë kaluar procedurën e miratimit në njësinë bazë për të qënë në përputhje me syllabusin përkatës të modulit. Në disa module pedagogët vënë në dispozicion të studentëve dhe një cikël leksionesh, dhe krahas tyre rekomandohet dhe literaturë shtesë.

Në mjediset e fakultetit të ekonomisë funksionon Biblioteka Shkencore, dhe gjithashtu në mesin kryesore të universitetit ndodhet biblioteka kryesore e universitetit. Biblioteka qëndron e hapur nga ora 08:00 në 16:00, dhe funksionon përmes kartelave të regjistrimit. Biblioteka e fakultetit ka një fond prej rreth 5447 libra (në shqip dhe gjithë të huaj) për fusha të ndryshme të studimit që lidhen me programet e studimit të fakultetit ekonomik, dhe me një sipërfaqe rreth 100 m²

IV - INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE

Standardi IV.1 - Njësia e institucionit ndjek një politikë të mirëprirjes së studentëve të rinj

Dispozitat e Ligjit 80/2015 janë baza ku mbështeten tërësisht procedurat dhe politikat që lidhen me studimet në UK. Statuti i UK¹²¹, neni 50 përcakton që pranimi i studentëve në programet e studimit të ciklit të parë, bëhet sipas kuotave të paracaktuara dhe është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe që plotëson:

-Kriterin e notës mesatare të përcaktuar çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave.

- Kriterin e rëndësisë (koeficienti i përcaktuar për shkollën nga vjen, si dhe gruplëndët, sa i takon përputhshmërisë me fushat dhe programet e studimit në UK) sipas përcaktimeve të njësive bazë.

Procedurat dhe rregullat që lidhen me ecurinë e ciklit të plotë akademik të studentëve për programet që mbulon Fakulteti Ekonomik (FE) janë të reflektuara në Rregulloren e Brendshme të FE-së. Në këtë rregullore specifikohen gjithashtu edhe rregullat e regjistrimit të studentëve, hartimit të planeve mësimore, struktura e vitit akademik, zhvillimit të provimeve, përgatitjes dhe shpërndarjes së diplomave etj. Sekretaria e ZIS (zyra e Informimit të studentëve) dhe sekretaria mësimore kontrollon dhe mbikqyr në mënyrë të vazhdueshme, zbatimin korrekt të këtyre rregullave. Mbështetur në kërkesat e ligjit 80/2015, rregullorja e programit të studimit ¹²² përcakton gjithashtu edhe procedurat e tërheqjes së diplomës.

UK ka hartuar dhe vënë në dispozicion udhëzues për studentët e regjistruar tashmë në programet përkatëse, ku përfshihen edhe udhëzuesi për përdorimin e sistemit dixhital PITAGORA. Ndaj sekretaria e departamenteve, së bashku me stafin e Departamenteve në takimet me studentët i informojnë ata në lidhje me këtë sistem si dhe në lidhje me përshtatjen e tyre më në mënyrën e organizimit dhe ecurisë mësimore, infrastrukturën, shërbimet dhe fasilitetet etj. ZIS, Sekretaria mësimore dhe koordinatori i programit të studimit janë mbështetësit bazë të këtij procesi.

Në zbatim të Ligjit 80/2015, neni 74, UK ndjek procedurat dhe informon vazhdimisht palët e interesuara për aplikimin e sistemit online të ministrisë për maturën shtetërore. Ndërkohë Ministria e Arsimit nëpërmjet portalit të saj administron procesin e hyrjes, sistemi informatik që siguron barazi, konfidencialitet të informacionit, njoftime në kohë reale, si dhe shërbime të ndryshme për studentët.

Në zbatim të këtij ligji Rektorati shpall me vendim kriteret e pranimit të studentëve në UK, i cili miratohet nga Senati Akademik, duke marrë në konsideratë vendimin për kriteret të marrë nga njësia bazë¹²⁵.

Strukturat që ndjekin zbatimin e vendimit janë Zv/Rektori për Mësimin, Drejtoria e Kurrikulave Sigurimit të Cilësisë dhe Kërkimit Shkencor (DKSCKSH), ZIS dhe Qendra e Karrierës dhe Alumni (QKA). Rregullorja e FE garanton barazi dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët duke mos lejuar diskriminime në bazë gjinie, origjine, etnie, apo shtetësie. Studimet në FE mund të ndiqen nga shtetas shqiptarë, shqiptarët etnike jashtë kufijve shtetërore si dhe nga çdo shtetas i huaj, në bazë të kriterëve të përcaktuar nga MASR, statuti i UK-s dhe rregullorja e studimeve të FE, neni 35.

Standardi IV.2 - Njësia e institucionit informon studentët në lidhje me politikat e punësimit

Informacionin e detajuar në lidhje me strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit, studentët mund ta sigurojnë nëpërmjet dokumentave të tilla si: rregullorja e fakultetit, rregullorja e programit të studimit, fletë palosjeve dhe leksionit të hapur që zhvillohet ditën e parë të vitit akademik nga koordinatori i programit. Informacioni gjendet në arkivën e njësisë bazë dhe në faqen elektronike të UK-së.

UK vë në dispozicion për studentët e programeve të studimit dokumentacionin / udhëzues të posaçëm për ti informuar në mënyrë të hollësishme në lidhje me modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.

Programet e lëndëve edhe ato të shkurtuara janë të publikuara në formë elektronike në sit-in e sekretarisë online si dhe në formë fizike pranë arkivës së njësisë bazë. Ndërkohë planet

mësimore¹⁵⁰, lëndët dhe modulet e programit të studimit si dhe kurrikulat e Stafit akademik janë të publikuara në web dhe gjenden të dokumentuara pranë përgjegjëses së njësisë bazë.

Informacioni në lidhje me praktikat mësimore vihet në dispozicion studentëve nëpërmjet një udhëzuesi të arkivuar pranë departamenteve. UK informon dhe mbështet studentët për mundësitë e punësimit dhe orientimin në tregun e punës.

Qendra e Karrierës dhe Alumnit e ngritur pranë UK është ajo që krijon lidhjen midis studentit, departamentit Financë-Kontabilitet dhe tregut të punës dhe inkurajon studentët të planifikojnë karrierën e tyre përmes trajnimeve, forumeve, seminareve dhe takimeve individuale me studentët.

QKA zhvillon "Modulin e Karrierës"¹⁵⁵, i cili është një cikël informacionesh që i përgatit studentët për tregun e punës. Moduli i Karrierës përfshin :

-Shkrimi i Curriculum Vitae(CV)

-Shkrimi i letrës së interesit

-Shkrimi i projekteve

-Shkrimi i temës së diplomës

-Mënyra e citimeve në punimet shkencore

-Këshilla studentëve për "Intervistën e Punës"

Ato zhvillohen në grupe me jo më shumë se 10 studentë.¹⁵⁶¹⁵⁷

Në funksion të këtij procesi në partneritet me Bashkinë e Korçës dhe Shërbimin Kombëtar të Punësimit, Qendra e Karrierës dhe Alumni pranë UK organizon "Panairin e Punës" Në stendën e universitetit prezantohen programet e studimit si edhe orientohen studentët dhe të sapodiplomuarit për kërkesat e punës në Rajonin e Korçës.¹⁵⁸

Në panairin e punës marim pjesë institucione, ndërmarrje dhe organizata të ndryshme, të cilët prezantojnë ofertat e tyre të punës dhe njihen nga afër nëpërmjet komunikimit të drejtpërdrejtë me intervista, me aftësitë dhe njohuritë që studentët disponojnë.

Standardi IV.3 - Njësia e institucionit disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimit të ciklit të parë

UK për disponimin dhe mbajtjen e statistikave vjetore për studentët që nga rregjistrimi deri në diplomim mbështetet në statut Neni 71 sipas të cilit, UK-ja detyrohet të mbajë në formë të shkruar në bazë të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, « Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën Shqipërisë»:

- Regjistrin themeltar të studentëve, që është dokumenti që vërteton regjistrimin e studentëve në UK¹⁶³. Ai plotësohet edhe në formë elektronike (Rregullore e Sekretarisë, neni 13).

- Regjistrin e arritjeve akademike, që është dokumenti që vërteton rezultatet e arritura nga çdo student i regjistruar në UK, sipas programeve të studimit. Ky plotësohet edhe në formë elektronike.

- Regjistrin e lëshimit të diplomave dhe çertifikatave, që është dokumenti që vërteton emetimin e tyre prej UK-së, i cili plotësohet edhe në formë elektronike.

-Sekretaria mësimore disponon edhe një regjistër të regjistrimit paraprak studentëve që përdoret deri në rregjistrimin final të studentëve fitues të UK-së.

Gjithashtu, rregullorja e sekretarisë për regjistrimin, ruajtjen e të dhënave dhe raportimin përcakton mbajtjen e statistikave vjetore për të diplomuarit si dhe plotësimin në kohë dhe me cilësi të të gjitha dokumentacioneve të mësipërme¹⁶⁴.

Përsa i përket të diplomuarve, rrjeti ALUMNI i universitetit përditëson të dhënat mujore nëpërmjet gjurmimit të tyre me telefon, email, ose formularë të shpërndarë në terren, me qëllim jo vetëm sigurimin e informacionit por edhe për të shkëmbyer përvojat më të mira në fushën e arsimimit dhe punësimit.

Statistikat vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, të tërhequr apo të larguar para përfundimit të programit të studimit disponohen nga sekretaria mësimore dhe në bazën e të dhënave të sistemit PITAGORA.

Gjithë dokumentacioni ruhet në regjistrat e sekretarisë mësimore prane FE, në sistemin PITAGORA dhe pasqyrohet i përpunuar në mënyrë të detajuar në raportin vjetor të analizës mësimore dhe kërkimore ¹⁶⁶ të njësisë kryesore.

FE disponon pranë sekretarisë mësimore: a.rregjistrin bazë të studentëve të dërguar format

nga MASR, ku çdo studenti i korrespondon një numër matrikullimi dhe udhëzimet përkatëse për plotësimin e tyre.

b- rregjistri paraparak për rregjistrimin fillestar të aplikimit të studenteve,

c- rregjistrin e vlerësimeve në provim sipas lëndëve përkatëse dhe diplomave ku shënohet numri i diplomës dhe lista e notave¹⁶⁸,

d- libër diplomimi ku hidhen të gjithë të dhënat e diplomës dhe në momentin e tërheqjes së dokumentit të diplomës firmoset nga studenti.

Diploma së bashku me suplementin e saj¹⁶⁹ ruhen në UK dhe më pas depozitohet në Arkivën Qëndrore sipas përcaktimeve të këtyre dokumenteve dhe një kopje e njëzuar me origjinalin ruhet në arkivën e UK sipas akteve ligjore të arkivave.

Sistemi PITAGORA shërben si një databazë elektronike për ruajtjen e informacionit të plotë të studentëve. Ky informacion përpunohet dhe transmetohet vit pas viti nga sekretaria mësimore dhe ZIS, deri në diplomën e studentëve.

Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen online përmes sistemit elektronik të informacionit PITAGORA.

Ndërkohë në rregulloret e studimeve të UK përcaktohet edhe përgjegjësia për regjistrimin, ruajtjen e të dhënave dhe raportimin e statistikave vjetore për të regjistruarit¹⁷⁰.

Është Sektori i IT, i cili kryen përpunimin statistikor të të dhënave, menaxhon sistemin, mjetet dhe procedurat e informacionit¹⁷¹.

Ai menaxhon mbledhjen, përpunimin, transmetimin dhe shfrytëzimin e të dhënave që kanë të bëjnë me veprimtarinë akademike që nga rregjistrimi i studentëve deri në diplomimin e tyre.

Sektori përpunon statistikën e të dhënave të ndryshme nga viti në vit dhe ua komunikon ato njësive përkatëse në UK.

Ky sektor është gjithashtu përgjegjës për zbatimin dhe mirëmbajtjen e platformës së sistemit dixhital të të dhënave të institucionit, si një mënyrë efektive dhe praktike komunikimi¹⁷². Ai vazhdimisht përditëson faqen zyrtare të UK¹⁷³ dhe informon mediat apo publikun e gjerë në lidhje me veprimtarinë akademike.

Po kështu është Drejtoria e Kurrikulave, Sigurimit të Cilësisë dhe Kërkimit Shkencor, përgjegjëse për përpunimin dhe ruajtjen e informacionit në lidhje me studentët e cila ka në varësi dy sektorë: 1- Sektori i Kurrikulës Vlerësimi Institucional dhe Alumni dhe Sektori i Projekteve Kërkimit Shkencor në përbërje të të cilit janë QKA dhe Sekretaria mësimore në bashkëpunim me sekretaren e njësive bazë ka për detyrë sigurimin e bazës së të dhënave dhe vënien në dispozicion të informacionit të nevojshëm për studimet dhe studentët, niveleve të ndryshme të drejtimit në FE.

Gjithashtu ky informacion pas grumbullimit dhe përpunimit prezantohet pranë Rektoratit dhe DKSCSKSH-së.

Standardi IV.4 Njësia e institucionit angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve

Organigrama e UK-së në përputhje me parashikimet ligjore të IAL-ve, përfshin si pjesë të saj disa Sektorë në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve. Kështu çdo vendim, rezultatet e analizave të ndryshme apo politikë të ndërmarrë nga Rektorati, Bordi i Administrimit, Senati Akademik dhe më tej nga Këshillat e fakulteteve dhe dekanati u bëhen të ditura studentëve, nëpërmjet njoftimeve në website, shpalljen e tyre në mjediset të ndryshme të universitetit (monitore, stenda, etj), hartimin e broshurave dhe fletëpalosjeve dhe takimeve të drejtpërdrejta me ta.

Ndërkohë pranë FE, gjithmonë duke koordinuar punën me QKA ndodhen Sekretaria mësimore dhe Sekretaria e departamentit, përkatësisht me Zyrën e Informimit të Studentëve, që luajnë një rol aktiv në plotësimin e kërkesave të studentëve në kohën e duhur¹⁹³.

Për tju erdhur në ndihmë universiteteve shqiptare dhe njëkohësisht edhe UK-së, në lidhje me informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit vecanërisht për sigurimin e mësimin online, RASH së bashku me GEANT kanë ofruar platformën VIRTUAL UNIVERSITY e cila ka dy aplikacione: Edumeet dhe Moodle.

Stafi IT i universitetit së bashku me RASH ka përgatitur dhe personalizuar këto aplikacione

për të gjithë përdoruesit (staf akademik dhe studentë).

Për të patur akses në aplikacionin Moodle¹⁹⁷, çdo pedagog apo student mund të përdorë kredencialet me të cilat ata kanë akses në programin dixhital PITAGORA. Në këtë aplikacion pedagogët do të gjejnë lëndën e tyre si dhe studentët e regjistruar në çdo kurs dhe program studimi, sikurse dhe në PITAGORA. Pedagogëve ju jepet mundësia të dërgojnë materiale studentëve të kurseve, të hartojnë teste, kuice, raste studimi apo dhe forma të tjera për aktivizimin, informimin dhe njëkohësisht kontrollin e vazhdueshëm të studentëve.

V-NJËSIA E INSTITUCIONIT OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI

Standardi V.1- Njësia e institucionit vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij

Në mjediset e fakultetit të ekonomisë funksionon Biblioteka Shkencore, dhe gjithashtu në godinën kryesore të universitetit ndodhet biblioteka kryesore e universitetit. Biblioteka qëndron e hapur nga ora 08:00 në 16:00, dhe funksionon përmes kartelave të regjistrimit. Biblioteka e fakultetit ka një fond prej rreth 5447 libra (në shqip dhe gjithë të huaj) për fusha të ndryshme të studimit që lidhen me programet e studimit të fakultetit ekonomik, dhe me një sipërfaqe rreth 100 m² ⁷⁷.

Në dispozicion të stafit akademik dhe të studentëve është vënë dhe libraria elektronike (U-LIBRARY)⁷⁸, që mundëson aksesimin online të një numri të konsiderueshëm revistash shkencore të shkencave ekonomike dhe të ngjashme. Kjo librari mund të aksesohet nga studentët dhe pedagogët nga kompjuterat ose telefonat smart. Në funksion të realizimit të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma të ndryshme të mësimdhënies për realizimin e mësimit. Këto platforma përdoren si për transmetimin e materialeve (leksione) tek studentët, por dhe si mënyra për vlerësimin e tyre, qoftë në formën e detyrave të kursit apo dhe në format të tjera që mund të përdoren për vlerësimin e studentëve.⁷⁹

Të dhëna më të detajuara në lidhje me Bibliotekën e UK gjenden në aneksin 4.10.

Përsa i përket mësimdhënies, personeli akademik ka në përdorim një sërë platformash online si Google Classroom, Getiminoogle Meet, Edu Meet, etj. Këto platforma janë përdorur si për transmetimin e dijeve tek studentët në formën e leksioneve, seminareve dhe për kontrollin e nivelit të dijeve të studenteve në formën e detyrave të kursit apo testeve të ndryshme.

Standardi V.2- Njësia e institucionit vë në dispozicion të studentëve laboratorë dhe mjedise të

përshtatshme mësimore dhe për formimin praktik

Programet e studimit në FE realizohet në disa godina të UK. Gajte vitit raportues godina e saj kryesore është në rikonstrukcion. Në dispozicion të studentëve janë në dispozicion një sërë ambjentesh, krahas ambjenteve të Fakultetit të ekonomisë ka dhe mjaft ambjente të përbashkëta ose dhe ambjentet të fakulteteve të tjera që përdoren dhe nga studentët e këtij programi studimi.⁷⁵ Infrastruktura e vendosur në dispozicion të zhvillimit të këtij programi mësimor përbëhet nga një pjesë e ndërtuar posacërisht për zhvillimin e mësimdhënies dhe një pjesë përbëhet nga ambjente të përshtatura për zhvillimin e mësimit, si dhe janë funksionale. Janë bërë përpjekje, që brenda buxhetit këto ambjente të pajisen me mjetet e nevojshme për zhvillimin e mësimit. Sallat e leksioneve janë të pajisura me videoprojektorë të cilët u vijnë në ndihmë stafit akademik për zhvillimin e mësimit. Të gjithë auditorët janë të pajisur me mjete e nevojshme për zhvillimin e mësimit (karrike, banga, tabela, etj.).

VII - INSTITUCIONI GARANTON MARRËDHËNIE BASHKËPUNIMI, TË BRENDSHME DHE TË JASHTME

Standardi VII.1 - Njësia e institucionit garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të vet

Për të rritur interesin e studentëve personeli akademik i kushton një rëndësi të veçantë dhe përfshirjes në leksione të hapura dhe të personaliteteve të shquara në fushën e financës apo të kontabilitetit, me qëllim sjelljen e perspektivave të reja të zhvillimeve në keto fusha.

Duke marrë në konsideratë sfidat që ndeshen në fushën e studimit, lektorët synojnë të nxitin imagjinatën dhe të inkurajojnë zhvillimin e aftësive krijuese të studentëve. Studentëve u kërkohet që njohuritë e marra gjatë leksioneve të konkretizojnë nëpërmjet detyrave të kursit që ata mund të realizojnë. Në përfundim të vitit të tretë të studimeve, studentëve u mundësohet dhe realizimi i një moduli të plotë mësimor që lidhet me praktikën mësimore dhe profesionale (2 ETCS). Kjo praktikë realizohet në institucione të ndryshme publike dhe subjekte të ndryshme private me të cilat UK ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi.

Standardi VII.2 - Njësia e institucionit garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj

Në varësi të përmbajtjes dhe objektivave të kurrikulës, të rezultateve të të nxënimit të lëndëve të veçanta dhe cilësisë së studentëve, metodat e mësimdhënies ndërthurin në mënyrë të natyrshme shpjegimet e leksioneve, seminarët, praktikat laboratorike, diskutimet në klasë, orët e mësimimit me qendër nxënësin, integrimin e teknologjisë së informacionit në mësimdhënie, projektet lëndore, detyrat e kursit, kontrollin e njohurive etj.

Programet e studimit u nënshtrohen procedurave të vlerësimit të cilësisë, të ndërmarra nga njësitë e brendshme të sigurimit të cilësisë, organet vendimmarrëse, autoritetet, stafi akademik, studentët dhe aktorët e tregut.

Kurrikula e tyre rishikohet në bazë të propozimeve të departamenteve, argumentet e të cilit mbështeten kryesisht në numrin dhe cilësinë e studentëve të regjistruar, si dhe në nevojën për të rinovuar ofertën akademike.

Analiza e sigurimit të brendshëm të cilësisë në lidhje me aktorët e përfshirë në programet e studimit hedh idenë e rishikimit të kurrikulave, në bazë të të dhënave të vjela nga pyetësorët dhe sondazhet me studentët.

Po kështu, sugjerohet përmirësimi i infrastrukturës që lidhet me cilësinë e programeve të studimit si: përdorimi i laboratorëve, përditësimi i dokumentacionit, përfshirja e mjeteve të teknologjisë së informacionit në disiplina të caktuara, ndryshimi i raportit të ngarkesës të disiplinave, përfshirja e njohurive të reja në lidhje me kërkesat e tregut, metodat e mësimdhënies, mënyrat e vlerësimit etj.

VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË

Standardi VIII.1 - Njësia e institucionit garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimit

Spektori i Kurrikulës Vlerësimit Institucional dhe Alumni është i përfshirë drejtpërdrejt në matjen e treguesve kyç të performancës së programeve të studimit dhe në hartimin e një plani pune për përmirësimet e mundshme. Veprimtaria e tij përshkruhet edhe në Manualin e Sigurimit të Cilësisë të UK dhe detajohet në planin kalendarik të veprimtarisë së këtij sektori²¹⁷. Ai koordinon punën e Njësive të SBC në fakultete dhe i raporton drejtpërdrejt autoriteteve të universitetit për masat që duhet të ndërmerren. Kjo njësi bën vlerësimin periodik të efikasitetit të veprimtarive mësimore dhe shkencore dhe ka pavarësi veprimi dhe akses në të dhënat e universitetit²¹⁸.

Fakulteti i Ekonomisë (FE) ka të ngritur Grupin e Vlerësimit të Brendshëm (GVB) me përfaqësim nga 3 njësi bazë dhe 1 përfaqësuese të studentëve²¹⁹. Kjo njësi, mbështetur në analizën statistikore të të dhënave, konstatimet e nxjerra nga regjistrat, në sondazhet, pyetësorët dhe intervistat e organizuara me stafin akademik, stafin ndihmësimor dhe administrativ dhe studentët

vlerëson ecurinë dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga FE.

GVB monitoron në mënyrë të vazhdueshme dhe vlerëson, periodikisht,²²⁰ rezultatet e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore- shkencore. Njësia funksionon në bazë të Rregullores së brendshme të Fakultetit të Ekonomisë miratuar në mbledhje Senati me Vendim Nr. 511, datë 30/ 09/2019²²¹.

Në fund të çdo semestri apo para sezonit të provimeve, organizohet pyetsor I studentëve për cilësinë²²² e mësimdhënies për modulet e çdo program studimi në semestrin përkatës. Vlerësimi I Brendshëm menaxhohet nga Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë. Ajo ka si qëllim kryesor të monitorojë aktivitetin e sigurimit të cilësisë në universitet dhe të bashkërendojë komunikimin mes tij dhe institucioneve të vlerësimit të jashtëm që përcaktojnë kriteret e cilësisë në Arsimin e Lartë Shqiptar.

Njësia për sigurimin e cilësisë (NJSC) është pjesë e strukturave ndihmësakademike me karakter administrativ në nivel njësie kryesore²²³.

Vlerësimi i brendshëm i programeve të studimit organizohet si rregull një herë në vit nga GVB dhe përdoret si burim për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë dhe për vlerësimin e jashtëm

KONKLUZIONE TË NJSBC:

Konstatime, problematika dhe rekomandime:

1. Vihet re një rënie e numrit të regjistrimeve në disa prej programeve kryesore, që fakulteti tradicionalisht ka ofruar. Pjesërisht, kjo rënie shpjegohet me probleme të ashpra që po kalon qarku ynë sidomos vitet e fundit, kryesisht të natyrës socio-ekonomiko-demografike, si dhe të një perspektive jo shpresëlënëse lidhur me punësimin dhe jo vetëm, të perceptuar nga të rinjtë e rajonit tonë.
2. Vihet re se një pjesë e studentëve orientohen drejt programeve të reja të hapura në të dy ciklet e studimit, të cilat mendohet se lehtësojnë punësimin e të diplomuarve, sepse duken më të orientuara ndaj nevojave më akute të tregut të punës dhe përshtaten më mirë me natyrën digjitale të të rinjve të sotëm (Informatikë Biznesi, Marketingu Digjital). Kjo, së bashku dhe me hapjen e programit profesional 2-vjeçar, kanë ndikuar së tepërmi në zbutjen e problemit me numrin e të regjistruarve dhe të diplomuarve.
3. Shqetësuese duket rënia sasiore dhe cilësore e studentëve në programet e Manaxhimit dhe Turizmit. Tryeza të rrumbullakta, diskutime periodike me pjesëmarrjen e shumë aktorëve dhe nën dritën e një informacioni të detajuar, janë emergjente, për t'i dhënë zgjidhje kësaj problematike shqetësuese.
4. Pavarësisht se nuk është përmendur më sipër, një model statistikor me karakteristika të mira psikometrike, i ndërtuar mbi bazën e të dhënave të nxënësve të shkollave të mesme të qarkut, lidhur me ndikimin e burimeve të informacionit në përzjedhjen e profilit studimor, parashikoi se burimet më të rëndësishme të informacionit, prej të cilave ndikohen nxënësit pritet të jenë aktivitetet e ndryshme të institucionit dhe promovimi i tyre kryesisht në rrjetet sociale. Kjo gjetje është mirë që të merret në konsideratë gjatë përpilimit të strategjisë promovuese të institucionit.

Masat që duhet të ndërmerren:

- Gjetjet e disa studimeve të realizuara nga Dekanati, të cilat konfirmojnë njëra-tjetrën, rekomandojnë fillimin e fushatës promovuese sa më parë (mundësisht në muajin nëntor të çdo viti akademik). Kjo fushatë duhet të jetë e mirëkoordinuar dhe e mirëpromovuar, sidomos në faqet Web të institucionit dhe në rrjetet sociale. Një gjë e tillë mendohet të ndikojë gradualisht në nivelin sasior dhe cilësor të prurjeve të reja.

- Rritja e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies, nëpërmjet përdorimit të teknikave të reja, përditësimit të materialeve dhe pasurimit me shembuj nga praktika.
- Nxitja e studentëve për të realizuar detyrat dhe projektet e përcaktuara në vlerësimin e vazhduar të çdo lënde.
- Gjetja e rrugëve për ndryshimin e mentalitetit fiks dhe të motivimit të ulët të një pjese të madhe të studentëve
- Të rritet pjesëmarrja e studentëve në projekte, konferenca studentore, tryeza të rumbullakëta, si mënyra motivuese për studentët.
- Institucioni duhet të gjejë urat e duhura të komunikimit me bizneset, duke u orientuar tek biznese të drejtuara nga individë largpamës, me strategji të mirëpërcaktuara, në funksion të përmirësimit të programeve mësimore të ofruara, praktikave mësimore, punës kërkimore-shkencore dhe të bashkëpunimeve frytëdhënëse për të ardhmen.
- Përfshirja e studentëve në studime kërkimore të realizuar nga anëtarët e departamentit.
- Krijimi i një baze të dhënash për ruajtjen e lidhjeve me studentët e diplomuar.
- Vendosja e lidhjeve të qëndrueshme me bizneset dhe institucionet për të orjentuar studentët e diplomuar drejt pozicioneve të kërkuara të punës.
- Orientimi i procesit të mësimnxënies bazuar në kompetencat.
- Duhet menduar dhe diskutuar se si gjuha e aftësive të jetë gjuha e përbashkët në komunikimin midis punëdhënësve dhe punëmarrësve, ku roli i fakultetit tonë në këtë bashkëpunim duhet të jetë përcaktues.
- Gjetja e mundësive nga fakulteti në bashkëpunim me rektoratin dhe aktorë të tjerë, për fuqizimin e infrastrukturës së fakultetit (pajisje kompjuterike, softuerike etj.), në funksion të punës kërkimore-shkencore dhe të mësimdhënies.

ANALIZA SWOT

Pikat e forta të institucionit

1. Rritja e përpjekjeve të stafit për rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies.
2. Realizimi i studimit të tregut me qëllim: (i) hapjen e programeve të reja (ii) rivlerësim e kurrikulave (iii) riorganizimin e programeve egzistuese të studimit (iv) testimin e ecurisë të programeve të studimit (v) gjykimin e nevojave të maturantëve.
3. Realizimi me sukses i procesit të vetëvlerësimit të disa programeve. Përdorimi i përvojës të fituar si nxitje në drejtim të rritjes të cilësisë edhe në programet e tjera të ofruara.
4. Përdorimi me efektivitet të metodave inovative të mësimdhënies. Procesi i mësimdhënies dhe mësimnxënies ka qënë interaktiv dhe ka stimuluar eksplorimin e dijes, nëpërmjet diskutimit, aplikimit dhe veprimit duke u përdorur *metodat praktike* dhe ato *eksploruese*.
5. Angazhimi maksimal i stafit dhe studentëve në procesin e vetë-vlerësimit të disa programeve të studimit.
6. Konsolidimi i programeve të studimit që ofrohen nga tre departamentet e fakultetit .

Pika të dobta

1. Mos plotësim i kuotave të miratuara.
2. Cilësi e pamjaftueshme e prurjeve të reja
3. Pjesëmarrje e ulët në projekte, pavarësisht disa sinjaleve inkurajuese.
4. Angazhim i ulët i stafit dhe studentëve në veprimtaritë kërkimore-shkencore
5. Përvetësim në nivel mesatar i dijeve teorike të studentëve.

6. Mungesa e një gjuhe të përbashkët në komunikimin e fakultetit me bizneset, sidomos në sektorin turistik.
7. Konfuzion në gjetjen e rrugëve të duhura lidhur me praktikat e studentëve.

c. Mundësitë

- Eksperienca dhe kualifikimet e stafit akademik rrit mundësinë për të aplikuar dhe bërë pjesë e projekteve të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare prej të cilave mund të përfitojnë direkt dhe/ose indirekt studentët.
- Shanse për rritjen e bashkëpunimit të Fakultetit me biznesin rajonal.
- Kthimi i fakultetit në një qendër trajnimi me njohuri ekonomike në rajonin juglindor të vendit.
- Pozita e favorshme gjeografike e rajonit për tërheqjen e studentëve edhe nga vendet kufitare për programe të ndryshme studimi.
- Mundësi punësimi si rezultat i rritjes të kërkesës të tregut për profesionin e ekonomistit.

d. Pengesat

- Hapje të programeve të reja në njësitë e tjera kryesore të Universitetit
- Hapja e programeve të reja në Universitetet e tjera
- Faktorët demografikë të cilët projektojnë në të ardhmen një vijim të rënies së numrit të nxënësve të rregjistruar në arsimin parauniversitar.
- Vështirësi në rekrutimin e një stafi të kualifikuar
- Vendimmarrje e centralizuar

PJESA II

TREGUES TË MATSHËM

TABELAT PËRMBLEDHËSE

- Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë: Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat; Personeli ndihmës Akademik dhe Administrativ (PNA dhe PA) (Tabelat 1 dhe 2)

Tabela 1

Fakulteti i Ekonomisë	Numri i PAE		Numri i PAK		Numri i PA		Total
	Gjithsej (a)	Tituj/Grada	Gjithsej (b)	Tituj/Grada	Gjithsej (c)	Tituj/Grada	(a)+(b)+(c)
Financë-Kontabilitet	13	11	3	-	1	-	17
Menaxhim	9	8	4	-	-	-	13
Marketing-Turizëm	10	9	3	3	1	-	14
Fakulteti	-	-	-	-	6	-	6
TOTAL	32	28	10	3	8	-	50

Tabela 2

Tabela 2-1 Lista e Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK). Departamenti Financë-Kontabilitet

Nr.	Personeli Akademik Efektiv (Emër Mbiemër)	Detyra në Dep.	Titulli/Grada	Nr.	Personeli Akademik me Kontratë (Emër Mbiemër)	Titulli/Grada
1	Anila Mancka	Përgjegjës	Prof.As	1	Ermira Bardhi	Msc.
2	Frederik Çuçllari	Dekan	Prof.As	2	Marsida Leka	Msc.
3	Majlinda Bello	Zv.Rektore	Prof.As	3	Sorina Koti	Dr.
4	Alketa Zheku	Pedagog	Prof.As			
5	Konstandin Nasto	Pedagog	Dr			
6	Eleni Vangjeli	Pedagog	Prof.As			
7	Klaudeta Merollari	Pedagog	Dr			
8	Klaudia Lipi	Pedagog	Dr			
9	Genci Gjançi	Pedagog	Dr			
10	Junada Sulillari	Pedagog	Msc			
11	Marsida Harremi	Pedagog	Dr			

12	Jorida Koçibelli	Pedagog	Msc			
13	Aida Mosko	Pedagog	Dr...			

Tabela 2-2 Lista e Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK). Departamenti Menaxhim

Nr.	Personeli Akademik Efektiv (Emër Mbiemër)	Detyra në Dep.	Titulli/ Grada	Nr.	Personeli Akademik me Kontratë (Emër Mbiemër)	Titulli/ Grada
1	Suela Gërdhe	Përgjegjës	Prof.As	1	Krisula Korça	Msc.
2	Mirela Çuçllari	Pedagog	Prof.As	2	Xhevahir Pelivani	Msc.
3	Sonela Stillo	Pedagog	Prof.As	3	Majlinda Samsuri	Msc.
4	Aida Gabeta	Pedagog	Prof.As	4	Elda Dollija	Dr.
5	Marinela Teneqexhi	Pedagog	Doc.Dr			
6	Eva Dhimitri	Pedagog	Dr			
7	Emil Frasheri	Pedagog	Dr			
8	Iva Pendavinji	Pedagog	Msc.			
9	Gentisa Furxhi	Pedagog	Msc.			

Tabela 2-3 Lista e Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK). Departamenti Marketing-Turizëm

Nr.	Personeli Akademik Efektiv (Emër Mbiemër)	Detyra në Dep.	Titulli/ Grada	Nr.	Personeli Akademik me Kontratë (Emër Mbiemër)	Titulli/ Grada
1	Ledina Alolli	Përgjegjës	Prof.As	1	Bernard Dosti	Prof.As. Dr.
2	Eleina Qirici	Pedagog	Prof.As	2	Edmond Hajrizi	Prof.Dr.
3	Esmeralda Shkira	Pedagog	Prof.As	3	Muhamet Geralla	Prof.As. Dr.
4	Oriola Theodhori	Pedagog	Prof.As			
5	Mamica Nene	Pedagog	Dr			
6	Dr. Alma Zhilla	Pedagog	Prof.As			
7	Marenglena Hoxhaj	Pedagog	Dr			
8	Landi Gushi	Pedagog	Dr			
9	Denada Olli	Pedagog	Dr			
10	Erjon Nexhipi	Pedagog	Msc.			

- Të dhëna Tabelore për numrin e programeve në ciklin e I-rë, të II-të dhe të III-të të studimeve, që ofrohen në Njësinë përgjegjëse (Tabela 3)

N R.	BA/ MP/M Sc/ PP	EMËRTIMI I PROGRAMI T	AKTIV/ JOAKT IV/ MBYL LUR	DATA E AKTIT TË HAPJES/ MBYLLJES/ RIORGANIZI MIT Nr.
1.	BA	Financë- Kontabilitet	Aktiv	Hapur më 04.08.1998 Vendim Nr. 142
2.	BA	Ekonomiks	Aktiv	Hapur më 27.07.2018 Urdhër Nr. 467
3.	BA	Menaxhim	Aktiv	Hapur më 29. 05.1992 Vendim Nr. 230
4.	BA	Informatikë Biznesi	Aktiv	Hapur më 12. 07. 2018 Urdhër Nr. 402
5.	BA	Administrim Biznesi në Marketing	Aktiv	Hapur më 29.05.1992 Vendim Nr. 230 Riorganizuar më 03.06.2013 Vendim Nr. 499
6.	BA	Administrim Biznesi në Turizëm	Aktiv	Hapur më 29.05.1992 Vendim Nr. 230 Riorganizuar më 03.06.2013 Vendim Nr. 499
7.	BA	Biznes dhe Tregti	Aktiv	Hapur më 09.07.2018 Urdhër Nr. 386
8.	MP ₍₆₀ kredite)	Financë- Kontabilitet	Aktiv	Riorganizuar më 01.10.2018 Vendim Nr. 575
9.	MP	Bankë dhe Sigurime	Aktiv	Hapur më 10.07.2018 Urdhër Nr. 388
10.	MP ₍₆₀ kredite)	Administrim Biznesi	Aktiv	Riorganizuar më 01. 10. 2018 Vendim Nr. 575
11.	MP ₍₆₀ kredite)	Marketing	Aktiv	Riorganizuar më 01. 10. 2018 Vendim Nr. 575
12.	MP ₍₆₀ kredite)	Turizëm	Aktiv	Riorganizuar më 01. 10. 2018 Vendim Nr. 575
13.	MP ₍₆₀ kredite)	Guidë Turistike	Aktiv	Hapur me Urdhër Nr 636 dt.05.10.1918
14.	Msc	Financë	Aktiv	Hapur më 20.11.2012 Vendim Nr. 575

15.

PP

Asistent
Menaxher

Aktiv

Hapur më 05.
07. 2018
Urdhër Nr. 370

Programet e studimit që ofroi Fakulteti i Ekonomisë, për vitin akademik 2021-2022 dhe nr. i lëndëve sipas tipit të veprimtarisë.

Nr	BA/ MP/MSc/ PP	EMËRTIMI I PROGRAMIT	NR I LËNDËVE SIPAS TIPIT TË VEPRIMTARISË						TOTALI
			A	B	C	D	E	F	
1.	Bachelor	Financë-Kontabilitet	6	19	5	6	1		37
2.	Bachelor	Ekonomiks	6	16	5	5	1		33
3.	Bachelor	Menaxhim	6	19	5	5	1		36
4.	Bachelor	Informatikë Biznesi	6	19	5	4	1		35
5.	Bachelor	Administrim Biznesi në Marketing	6	19	5	5	1		36
6.	Bachelor	Administrim Biznesi në Turizëm (viti III) riorganizuar si Menaxhim në turizëm dhe mikpritje	6	19	5	5	1		36
8.	Master Profesional _(60 kredite)	Financë-Kontabilitet	1	5	4	2	1		13
9.	Master profesional	Bankë dhe Sigurime	1	5	4	2	1		13
10.	Master Profesional _(60 kredite)	Administrim Biznesi	1	5	4	1	1		12
11.	Master Profesional	Marketing	1	5	4	2	1		13
12.	Master Profesional	Marketingu digjital	1	5	4	2	1		13
13.	Master Profesional	Menaxhim i turizmit, atraksioneve dhe eventeve	1	5	4	2	1		13
14.	Master Shkencave	i Financë	1	11	4	2	1		19

15.	Program Profesional	Asistent Menaxher	3	11	3	4	1		22
-----	---------------------	-------------------	---	----	---	---	---	--	----

Numri i stafit të Fakultetit të Ekonomisë, 2021-2022

Staf drejtues	Staf akademik (+ stafi drejtues)	Stafi administrativ
5	32	8

Ngarkesa mësimore e stafit akademik të departamentit Financë-Kontabilitet (2021-2022)

Nr.	Emri Mbiemri	Ngarkesa për 2021-2022 (orë)
1.	Prof. As. Dr. Anila Mançka	330
2.	Prof. As. Dr. Frederik Çuçllari	467
3.	Prof. As. Dr. Alketa Pasholli	344
4.	Prof. As. Dr. Eleni Vangjeli	414
5.	Prof. As. Dr. Majlinda Bello	454
6.	Dr. Konstandin Nasto	435
7.	Dr. Klaudeta Merolli	382
8.	Dr. Klaudia Lipi	391
9.	Dr. Marsida Harremi	354
10.	Dr. Genci Gjançi	308
11.	Msc. Junada Sulilari	420
12.	Msc. Jorida Koçibelli	427
13.	Dr. Aida Mosko	368
	Mesatare	391.85

Ngarkesa mësimore e stafit akademik të departamentit Menaxhim (2021-2022)

Nr.	Emri Mbiemri	Ngarkesa për 2021-2022 (orë)
1.	Prof. As. Dr. Suela Gërdhe	300
2.	Prof. As. Dr. Aida Gabeta	397
3.	Prof. As. Dr. Mirela Cini	360
4.	Prof. As. Dr. Sonela Stillo	348
5.	Doc. Dr. Marinela Teneqexhi	437
6.	Dr. Eva Dhimitri	365
7.	Dr. Emil Frashëri	370
8.	Dr. Gentisa Furxhi	371
9.	Msc. Iva Pendavinji	300
	Mesatare	360.89

Ngarkesa e stafi akademik te departamentit Marketing-Turizem viti akademik 2021-2022

	Stafi Akademik	Ngarkesa 2021-2022 (orë)
1.	Prof.Asoc.Dr. Ledina Alolli	282
2.	Prof.Asoc.Dr. Esmeralda Shkira	395

3.	Prof.Asoc.Dr. Eleina Qirici	306
4.	Prof.Asoc.Dr. Oriola Theodhori	376
5.	Prof.Asoc.Dr. Mamica Nene	365
6.	Dr.Marenglena Hoxhaj	352
7.	Dr. Landi Gushi	476
8.	Dr. Denada Olli	368
9.	Dr.Alma Zhilla	366
10.	Msc.Erjon Nexhipi	397
	Mesatare	368.3

Ngarkesa mësimore sipas pedagogëve varjon nga 290 deri 476 orë, me një mesatare ngarkese prej 373.68 orë/pedagog. Kemi një rritje mesatare në masën 3%, krahasuar me ngarkesën mesatare (362.59) të vitit të kaluar. Pedagogët efektivë të departamentit të Financë-Kontabilitet kanë një ngarkesë mesatare prej rreth 8.6% dhe 6.4% më të lartë se homologët e departamenteve të Menaxhimit dhe Marketing-Turizmit, respektivisht.

Shkalla e kualifikimit e stafit akademik dhe e stafit mbështetës

KUALIFIKIMI	DEPARTAMENTI FINANCË- KONTABILITET			DEPARTAMENTI MENAXHIM			DEPARTAMENTI MARKETING- TURIZËM		
	Stafi akademik		Stafi administrativ	Stafi akademik		Stafi administrativ	Stafi akademik		Stafi administrativ
	Nr	%	Nr	Nr	%	Nr	Nr	%	Nr
TITUJ	5	38.46		4	44.45		5	50.00	
GRADA	6	46.15		4	44.45		4	40.00	
MSc	2	15.39		1	11.10		1	10.00	
MP	-	-		-	-		-	-	
BA	-	-	1	-	-		-	-	1
PA TITUJ DHE GRADA		15.39			11.10			10.00	

Stafi (efektiv) i kualifikuar me grada dhe tituj në nivel Fakulteti përbën **87.83 %** të totalit, përkatësisht:

Departamenti Financë - Kontabilitet → **84.62 %**,

Departamenti Menaxhim → **89.00%**,

Departamenti Marketing - Turizëm → **90.00%**.

Tabela Shpërndarja e stafit akademik me kohë të plotë dhe të pjesëshme, sipas departamenteve, për vitin akademik 2021-2022

Departamenti	Staf akademik	Prof.dr.	Prof.as.dr.	Dr.	Asistent pedagog	Total
Financë-Kontabilitet	Pedagogë me kohë të plotë	-	5	6	2	13
	Pedagogë me kohë të pjesëshme	-	-	1	2	3
Menaxhim	Pedagogë me kohë të plotë		4	4	1	9
	Pedagogë me kohë të pjesëshme				4	4
Marketing-Turizëm	Pedagogë me kohë të plotë		5	4	1	10
	Pedagogë me kohë të pjesëshme	1	2			3
Totali	Pedagogë me kohë të plotë		14	14	4	32
	Pedagogë me kohë të pjesëshme	1	2	1	6	10

32 pedagogë ishin me kohë të plotë dhe 10 ishin e kohë të pjesëshme. Nuk u vu re ndonje lëvizje e rëndësishme në strukturën e stafit, lidhur me titujt dhe gradat, megjithëse disa prej tyre janë në fazën finale të përbushjes së detyrimeve të shkollës së Doktoraturës.

Raportet midis stafit me kohë të plotë, stafit e kohë të pjesëshme dhe studentëve paraqitet në tabelën mëposhtë.

Tabela . Raporte të stafit sipas programeve të studimit 2021-2022

Programi i studimit	Njësia	Nr i ped të brendshëm	Nr i pedagogëve të jashtëm	Raporti Staf i brend./me kohë të pjesëshme	Raporti pedagog BB /student
PP: “Asistent menaxher”	Dep. Mxh	19	4	19/4	1/ 2.5
Bch: “Informatikë biznesi	Dep. Mxh	25	7	25/7	1/1.28
Bch: “Menaxhim”	Dep. Mxh	23	2	23/2	1/2
MP: “Administrim biznesi”	Dep. Mxh	10	1	10/1	1/2
Bch “Menaxhim në Turizëm dhe Mikpritje”; “Administrim Biznesi në Turizëm” Viti III	Dep. Mrkt-Tur	30	3	30/3	30/51

Bch. “Administrim Biznesi në Marketing”	Dep. Mrkt-Tur	33	4	33/4	33/81
MP “Menaxhim i Turizmit Atraksioneve dhe eventeve”	Dep. Mrkt-Tur	10	-	10/-	10/5
MP “Marketing”	Dep. Mrkt-Tur	9	1	9/1	9/15
MP “Marketingu Digjital”	Dep. Marketing-Turizëm	9	2	9/2	9/9
Financë - Kontabilitet	Dep. Fin-Kontabil.	30	3	30/3	33/257
Ekonomiks	Dep. Fin-Kontabil.	27	3	27/3	27/31
MP: Financë -Kont	Dep. Fin-Kontabil.	11	1	11/1	11/34
MP: Bankë Sigurime	Dep. Fin-Kontabil.	10	1	10/1	10/6
MSH: Financë	Dep. Fin-Kontabil.	15	-	15/-	15/22

- Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese në rang Programi/esh studimi për Praktikant profesional me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lart.

Bashkëpunime dhe projekte të FE me patrnerë të ndryshëm Fakulteti i Ekonomisë gjatë periudhës 2021-2022 u angazhua në bashkëpunime dhe projekte të ndryshme, të cilat ndihmuan kryesisht studentët, që ata të gërshetojnë një pjesë të dijeve të marra në programet e fakultetit me anën praktike të tyre.

- Në kuadrin e bashkëpunimeve nga Fakulteti i Ekonomisë, departamenti i Financë-Kontabilitetit vazhdon bashkëpunimin me kompani të suksesshme të Qarkut dhe me ekspertë kontabël, ndërkohë që departamenti Marketing-Turizëm vazhdon bashkëpunimin me fondacionin ‘La Fondation pour la formation Hoteliere’ ku çdo vit ka qënë pjesëmarrës në konferencat e organizuara prej tij. Gjithashtu ky fondacion ofron që prej 2015 Bibliotekën

online falas për studentët dhe 5 pedagogë. Gjithashtu për vitin 2021-2022 fondacioni ofroi për studentët dhe pedagogët programin REVsim Stimulation. Të dhënat lidhur me këtë aspekt, paraqiten në tabelën mëposhtw.

Bashkëpunime dhe projekte të FE me patrnerë të ndryshëm

INSTITUCIONET BASHKËPUNUESE /PROJEKTI	INFORMACIONI MBI KONTRATËN	DATA/FORMA E ZYRTARIZIMIT	FUSHA E BASHKËPUNIMIT	DETYRAT	PËRFITIMET
FIX PRO SHPK	Me afat të pacaktuar	05.12.2019	Zhvillimi i praktikës profesionale	Departamenti bën ndarjen e studentëve në grupe, cakton pedagogët shoqërues të praktikës. Subjekti merr masat e duhura për realizimin e programit të praktikës	Realizimi i tryezave të rrumbullakta , seminareve trajnuese me specialistë të institucionit, vizita te subjekti etj.
Kontabël i miratuar Mirgena Ymer	Me afat të pacaktuar	21.11.2019	Zhvillimi i praktikës profesionale	Departamenti bën ndarjen e studentëve në grupe, cakton pedagogët shoqërues të praktikës. Subjekti merr masat e duhura për realizimin e programit të praktikës	Realizimi i tryezave të rrumbullakta , seminareve trajnuese me specialistë të institucionit, vizita te subjekti etj.
Kontabël i miratuar Fatmir Ceci	Me afat të pacaktuar	19.12.2019	Zhvillimi i praktikës profesionale	Departamenti bën ndarjen e studentëve në grupe, cakton pedagogët shoqërues të praktikës. Subjekti merr masat e duhura për realizimin e programit të praktikës	Realizimi i tryezave të rrumbullakta , seminareve trajnuese me specialistë të institucionit, vizita te subjekti etj.
Auditues ligjor Ilda Ikonomi	Me afat të pacaktuar	24.02.2020	Zhvillimi i praktikës profesionale	Departamenti bën ndarjen e studentëve në grupe, cakton pedagogët shoqërues të praktikës. Subjekti merr	Realizimi i tryezave të rrumbullakta , seminareve trajnuese me specialistë të institucionit, vizita te

				masat e duhura për realizimin e programit të praktikës	subjekti etj.
UNION BANK	Me afat të pacaktuar	3.10.2019	Zhvillimi i praktikës profesionale	Departamenti bën ndarjen e studentëve në grupe, cakton pedagogët shoqërues të praktikës. Institucioni merr masat e duhura për realizimin e programit të praktikës	Realizimi i tryezave të rrumbullakta , seminareve trajnuese me specialistë të institucionit, vizita te subjekti etj.
“Larti” shpk	Me afat të pacaktuar	19.10.2019	Zhvillimi i praktikës profesionale	Departamenti bën ndarjen e studentëve në grupe, cakton pedagogët shoqërues të praktikës. Subjekti merr masat e duhura për realizimin e programit të praktikës	Realizimi i tryezave të rrumbullakta , seminareve trajnuese me specialistë të institucionit, vizita te subjekti etj.
Birra Korca	Me afat të pacaktuar	15.06.2020	Zhvillimi i praktikës profesionale	Departamenti bën ndarjen e studentëve në grupe, cakton pedagogët shoqërues të praktikës. Subjekti merr masat e duhura për realizimin e programit të praktikës	Realizimi i tryezave të rrumbullakta , seminareve trajnuese me specialistë të institucionit, vizita te subjekti etj.
TONA, ALB, KORCE	Me afat të pacaktuar	15.06.2020	Zhvillimi i praktikës profesionale	Departamenti bën ndarjen e studentëve në grupe, cakton pedagogët shoqërues të praktikës. Subjekti merr masat e duhura për realizimin e programit të praktikës	Realizimi i tryezave të rrumbullakta , seminareve trajnuese me specialistë të institucionit, vizita te subjekti etj.
Instituti i		21 Shtator	Biblioteka	Instituti i	5 pedagogë

Mikpritjes(Institute of Hospitality)		2020	online	Mikpritjes ofron bibliotekën online. Departamenti Marketing-Turizëm promovon dhe regjistron studentët në bibliotekën online.	dhe studentët përdorin falas bibliotekën online.
La fondation pour la formation hoteliere		Korrik 2021	REVsime STIMULATION	Fondacioni paguan për shërbimin e ofruar nga kompania	Studentët mësojnë nëpërmjet programit REVsime

Kërkimi shkencor dhe projekte

Pjesëmarrje në konferenca dhe aktivitete të tjera shkencore nga stafi akademik i Fakulteti i Ekonomisë për periudhën 2020-2021 Pjesëmarrje e stafit në konferenca dhe aktivitete të tjera të karakterit kërkimor-shkencor

NR	EMËRTIMI	TITULLI	PJESËMARRËSIT	Data
1-	Konferenca Ndërkombëtare e ASECU	Albania An Analysis Of The Funding Challenges In The Covid-19 Era: A Case Study Of Albanian SME-s	Kostandin NASTO; Junada SULILLARI	23- 24 Shtator 2022
2-	Konferenca Ndërkombëtare e ASECU	The Progress Of Demographic Growth In Albania. Analyze Of Influencing Factors	Eleni VANGJELI; Kostandin NASTO; Mamica NENE	23- 24 Shtator 2022
3-	Konferenca Ndërkombëtare e ASECU	Digitalization Of Public Services In Albania During The Pandemic Period	Erjon NEXHIPI	23- 24 Shtator 2022
4-	Konferenca Ndërkombëtare e ASECU	Analysing The Relationship Between Risk, Capital And Efficiency In Albanian Banking System	Aida MOSKO; Klaudia LIPI; Klaudeta MEROLLARI	23- 24 Shtator 2022
5-	Konferenca Ndërkombëtare e ASECU	Income Inequality	Majlinda BELLO	23- 24 Shtator 2022
6-	Konferenca	The Impact Of Public,	Jorida KOÇIBELLI	23- 24 Shtator

	Ndërkombëtare e ASECU	Private And Foreign Direct Investments On The Economic Growth Before And During The Coronavirus Pandemic (Covid-19). The Case Of Albania		2022
7-	Konferenca Ndërkombëtare e ASECU	An Empirical Analyse Of Online Customer Behavior Albania In Focus	Oriola THEODHORI; Ledina ALOLLI	23- 24 Shtator 2022
8-	Konferenca Ndërkombëtare e ASECU	Impact Of The Covid-19 Pandemic On Albanian Business, Study For SMEs In Korça	Klaudeta MEROLLARI, Anila MANÇKA	23- 24 Shtator 2022
9-	Konferenca Ndërkombëtare e ASECU	The Informal Economy In Albania. Analysis Of Its Forms And Effects Of Covid-19	Marsida HARREMI, Klaudia LIPI	23- 24 Shtator 2022
10-	Konferenca Ndërkombëtare e ASECU	Analysis Of The Economic Development Of Albania, Before And After The Pandemic Covid-19	Klaudia LIPI , Marsida HARREMI	23- 24 Shtator 2022
11-	Konferencë ndërkombetare	International online conference, In K. M. Hogan, & A. Kostyuk (Eds.), Corporate governance: Fundamental and challenging issues in scholarly research	Junada SULILLARI Kostandin NASTO	2021
12-	International Conference “Research, application and educational methods”	“Content of television broadcasts. Implementation or violation of children’s rights?”	Iva PENDAVINJI	2021
13-	6th International Conference “Inovations and Perspectives of Contemporary Education”	“The acces of disabled people in education. Actual issues and case law”	Iva PENDAVINJI	2022
14-	ASECU 18 th International	. “The restriction of human rights and	Iva PENDAVINJI	23-24 September, 2022

	Conference Socio-Economic Challenges in the Post-Pandemic Period”	freedoms during pandemic”		
15-	International Balkan and Near Eastern Congress Series on Economics.	. “The impact of demographic variables on employee’s change readiness. Case study: Municipalities Employees of Korca’s Region”	Gentisa FURXHI; Sonela STILLO; MarinelaTENEQEXHI	12-13March 2022 Plovdiv, Bulgaria.
16-	The 5th International Conference on Advanced Research in Social Sciences (ICARSS)	“Effects of subjective and objective knowledge on apple consumers Case of an apple producing area in Korca, Albania	Erjon NEXHIPI	Cambridge, UK, August 26-28, 2022
17-	Konferenca shkencore nderkombetare: IACHSS 2022	“Gender policies in Albania from a European perspective	Erjon NEXHIPI	(Paris, 19 – 21 gusht 2022)
18-	FH Conference Theme : Hospitality and Tourism Stakeholders' social, economic, and environmental responsibilities during or post COVID with a subtheme of Distance Learning and NewTechniques - Lessons learnt from Lockdown	“A review of the pandemic experience of tourism and hospitality sector in Albania. Methods to be followed for its recovery, towards sustainable tourism.”	Alma ZHILLA	28 shtator-2 tetor
19-	Konferenca Shkencore Ndëruniversitare “Mundësitë dhe Sfidat për një Zhvillim të Qëndrueshëm të Turizmit	<i>“Përfshirja e komunitetit në zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit kulturor .”</i>	Alma ZHILLA	27 Maj 2021
20-	Konferenca "Ekonomia Shqiptare: Perspektivat & Sfidat e Politikave Ekonomike"	Pjesëmarrje pa punim	Alma ZHILLA	23 Gusht 2021

	organizuar nga Balkans Youth Council			
21-	SIMPOZIUM			
22-	SEMINARE	Siguria në sistemet bankare.	Klaudeta MEROLLARI Jorida KOÇIBELLI	9 Mars 2022, Korçë
23-	SEMINARE	Research Seminar: Tourism and Place	Dr. Alma Zhilla	26 Maj 2022 IPM (Institute of Place Management)
24-	SEMINARE	Hartimi i strategjisë së specializimit inteligjent(sektori i agroturizmit dhe turizmit malor	Esmeralda Shkira	
25-	LEKTORIUM	"Stabiliteti financiar dhe Menaxhimi i Krizave". Profesore Magdalena Kozińska, Universiteti i Ekonomisë, Varshavë.	Departamenti i Financë-Kontabilitetit Studentët e programit të studimit Master i shkencave në Financë	6 qershor 2022
26-	LEKTORIUM	Destinacionet turistike të suksesshme (Dr.Maria Buenarota)		
27-	KONGRES XVI. International Balkan and Near Eastern Congresses Series on Economics, Business and Management IBANESS Congresses Series on Economics, Business and Management-	“Ndikimi i guidave turistike në rritjen e kënaqësisë së turistëve.”(Rasti studimor Qarku i Korçës, Shqipëri)	Alma ZHILLA	29-30 Maj 2021, Plovdiv/Bulgaria
28-	KONGRES VII International	Realiteti virtual dhe roli i tij në turizmin kulturor (Rasti studimor në	Alma ZHILLA	12-13 Mars 2022, Plodviv, Bulgaria

	Balkan and Near Eastern Congresses Series on Economics, Business and Management IBANESS Congresses Series on Economics, Business and Management-	Shqipëri)		
29-	Leksion i hapur	Roli i mikrofinancës në periudhën e pandemisë Covid-19", Të ftuar drejtues dhe specialistë të financës në institucionin financiar NOA sh.a	Departamenti i Financë-Kontabilitetit Kordinatore Dr. Klaudia Lipi	13 prill 2022
30-	Konference studentore	“Implikimet menaxheriale në modelet e reja të të bërit biznes”, Albanian University UFO në bashkëpunim me Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit <u>Universiteti "FAN S. NOLI" Korçë,</u>	Studentë të programit të studimit Master profesional Financë-Kontabilitet Kordinatore Eleni Vangjeli	17 mars 2022
31-	WORKSHOP	Programi i studentëve”, intershipet dhe punësimet në kuadër të bashkëpunimit institucional me drejtues të raiffeisen bank	Departamenti i Financë-Kontabilitetit Studentë të programeve Bachelor Financë-Kontabilitet dhe Ekonomiks	
32-	TRAJNIM	Trajnimi mbi Hartimin dhe Menaxhimin e Projekteve	Jorida KOÇIBELLI	6 Tetor 2021, Tiranë
33-	TRAJNIM	Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive. Persa i takon Programit të Punësimit, Nxitjes së Punësimit, Programit të Praktiave Profesionale, si dhe shërbimeve të tjera të ofruara nga kjo agjenci.	Departamenti i Financë-Kontabilitetit Studentë të programeve Master Profesional në “Financë-Kontabilitet” dhe “Bankë e Sigurime”	22 maj 2022
34-	Leksion i hapur	Auditimi i pavarur”- e ftuar znj. Anila Çunoti, kontabël i miratuar, auditues ligjor	Studentë të programeve master profesional në “financë-kontabilitet” dhe master i shkencave në “financë”, kordinatore Alketa Pasholli	27 maj 2022
35-	SEMINARE	Trajnim me teme:	Klaudia LIPI	18 Mars 2022

